



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

KËSHILLI I BASHKISË MALLAKASTËR

Nr. 326 prot.

Ballsh, më 24. 01. 2023

VENDIM

Nr 01 datë 23 / 01 / 2023

PER MIRATIMIN KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6 % TE FONDIT TE KUSHTEZUAR PER BLOK-NDIHMEN ME FONDET E PUSHTETIT QENDROR DHE VENDOR PER VITIN 2023.

Keshilli bashkiak ne mbledhjen e dates 23/01/2023, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Ceshjteve Sociale, si dhe mbeshtetje te Ligjin nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore "Ligjit Nr 9936 date 26/06/2008" Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" I ndryshuar, Ligjin Nr 109/2017: Ligjit Nr 57/2019 "PER ASISTENCEN SOCIALE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", Neni 21 "Roli i Keshillit Bashkiak" VKM Nr 597 date 04/09/2019, te Keshillit te Ministrave" Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore e perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", "Kapitulli IV "Perdorimi i fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike" : VKM.Nr 868, date 29/12/2021, Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr 597, Date 04.09.2019, te Keshillit Te Ministrave" Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", si dhe Udhhezimet, e Ministrise se Shendetesisë dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri 6 %, me fondet e buxhetit qendror dhe vendor, propozuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Ceshjteve Sociale:

VENDOSI:

Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 %, të fondit të kushtezuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe ato që do trajtohen me fondet e buxhetit vendor, si me poshtë vijon ;

Kriteret për perfituesit nga programi I bllok-ndihmes 6 % nga fondi I kushtezuar dhe me fondet e buxhetit vendor :

- ❖ Familjet te cilat kane aplikuar per ndihme ekonomike,brenda tre muajeve dhe nuk jane perzgjedhur fituese nga sistemi i pikezimit.
- ❖ Familjet te cilat perzgjidhen per tu trajtuar me kete fonde duhet te jene te verifikuara paraprakisht nga Administratori shoqeror.
- ❖ Familjet e perzgjedhura duhet te jene familje ne nevoje,pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje me Kryefamiljar/e, burra/ gra(vajza nena/ burra baba , te ve/ja, te divorcuar/a),me te pakten nje femije: te mitur,ndjek arsimin baze ose te larte.
- ❖ Familje kur K/familjari ose antare te familjes,qe jane te paafta per pune ,por per shkak te Legjislacionit ne fuqi nuk perfitojne pagesa P.A.K.
- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe,pleqe dhe individe te vetmuar,pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje qe kane femije ne moshe madhore,por qe kane probleme sociale te cilet kane veshtiresi punesimi.
- ❖ Prinder qe kane shume femije.

Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale,do te propozoje cdo muaj numrin e familjeve per cdo Njesi ne baze te fondit te disponueshem.

Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETARI I KESHILLIT

Fitim BARAJ